


BIBLIOTEKA
SHTETIT

854-1
292



VIKTOR
QURKU

44

MOS HARRONI

VJERSHA
E POEMA

8 JH-1
RPT

VIKTOR QURKU

MOS HARRONI

(vjersha dhe poema)



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

ГИОЯЯН ГОМ

(вакуум-формація)

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re

Tiranë, 1976

MOJ FAMËMADHE

Shqipëri,
moj famëmadhe,
s'ka rrebesch
të të hedhë,
balli yt
i vetëtitur,
fjala jote
mori dhenë.

Moj e vogël,
një pëllëmbë,
e madhe për socializëm.

Fjalëmbël
me miqtë,
me armiqtë
zjarr e krisëm.

As me topa,
as me tanke,
as me thikë
e bajoneta
trupin dheut
dot s'ta shqitën,

moj e vogëla,
e serta.

As me lajkëza
prej goje,
as me mallra
tregtarësh,
s'u gënjeve,
s'u dobësove,
s'u lajthite
tradhtarësh.
Për armiqtë
mbete halë,
nëpër shekuj
kockë e fortë,
trimja ti,
moj armëlarë,
Vetëtimë
në Evropë,

TË LIRË KUSH E DO VATANIN

Shkëmbinj të thinjur, shkëmbinj
mbi Gjorm, mbi Lepenicë,
 mbi Brat,
ushtri e tërë gurësh të mëdhenj
thua do rrokullisen
 vrap.

Nga ç'kohë këtu ata mbetën
~~të palëvizshëm e të shurdhët~~
~~mes bleqërimave e mes erërave,~~
mes motorëve e mes grunjérave?

Nga ç'shekull këtu qëndrojnë
të thinjur në shi
 e në diej?
Fëmijët posa kuaj i shalojnë
dhe u flasin me zë qiejve.

Të ngjitesha majë malit të dëshirës,
t'i flas Shqipërisë
 tej e mbanë:

këta shkëmbinj nuk zbritën në

Shushicë,

përmbi armiq

rrokullimë ranë.

Nga rrokullima e tyre, malit
u bënë përrenj gjer mbi Shushicë,
sepse të lirë kush e do vatanin
dhe malet mbi armiqtë i përbrys.

POEMË PËR BIRÇE SINEMATIN

Te cila ditë të mbahem
e cilën ditë të lë mënjanë,
gjithë ditët e tua — vetëtimë,
more Birçe Sinemati.

Vij të të kërkoj në Kuç
ti në Kallarat e Bolenë ke arritur,
vij në Bolenë te rrapi,
ti zbret kaldrëmit të Gjirokastrës.

Partia pret informata,
ti Kurveleshin i tregon në këmbë,
një më një bien fjalët mbi tavolinë,
një më një dua t'i mbledh.

Po ti më ikën, më shket nga duart,
s'ke kohë, nxiton drejt lirisë,
s'të zë syri i spiunëve ty,
s'të arrin plumbi i fashistëve.

E unë rrekem të mbahem diku,
në oborrin e së fejuarës tënde hyj,
pyes kur do të kthehet.

* * *

Ka lënë dyrekun e shtëpisë djegur
e shkon t'u verë flakën katilëve,
ka lënë një dynym tokë pa mbjellur
e shkon të bëhet zot i gjithë dheut,
ka lënë nënën plakë vetëm
e shkon t'u thajë lotët gjithë nënave,
ka lënë te pragu të fejuarën,
e është fejuar me atdheun.
Shikojmë si e kapërcen Bogonicën,
si i përkëdhel me dorë dhe gurët,
duan ta mbërthejnë në Himarë,
në Gjorm del e tund malin,
duan ta shtijnë në dhe në Delvinë,
në Sopot del. u bën varrin.
Hajde ç'vrap i bukur lirie,
hajde ç'pushkë e nxeh të mbi supe,
hajde ç'djem që e ndjekin,
hajde ç'yje mbi gjerdanë.
Ikën behari e vjen dimri,
ai kapton gryka e kapton gjemba,
t'i dinin malet dhimbjet e këmbëve,
do të uleshin, mbi Birçe Sinematin.
T'i dinin fushat gishtërinjtë jashtë,
me bar e lule do të visheshin.

Por ai s'ndalet,
tutje nëpër borë e nëpër plumba,
ulu, Sopot, të shikosh
me një plumb batalionin mbron e s'tundet
uluni male me radhë,
më gjunjë para jush ai ulet,
Zagorie mbahu dhe ca,
t'i shikoj lotët e butë mbi të rënë,
ndalu, Vjosë, mos rriddh,
shiko Birçen mes shiut të plumbave.

*
* * *

Ku shkon, komisar, ku shkon?
Nata është e zezë dhe e lagësht,
prapa natës, ballistët
me shpirt më të zi se nata prinë.
Kapota qull të kullon nga këmbët,
pse s'kthehesht ta thashë, komisar,
diku te një kasolle e varfër, ta thashë.

*
* * *

Prite Kajcë partizane,
prise Kajcë e rrëthuar.

Trimat kurrë, trimat jo
 armët kurrë s'i dorëzojnë.
Ç'thotë ajo letër e thjeshtë,
 nëpër natë kujt vallë ia shkruan?
— Hajdeni, qen, në ua mban?
 Armët sonte provojmë.

*
* *

Hapen dritaret sonte,
 njerez të mirë të kësaj toke
shikojnë si vjen Birçe Sinemati
 duke mbushur mauzerin,
vrapon mal më mal,
 kapërcen harrimin, vrapon,
vrapon, kapërcen vdekjen,
 kthehet prapë, kthehet.

S H Q I P T A R

Shqiptar, në gurin tënd,
gjithë jeta të erdh në mend.

Shkove stinë, shkove halle
nëpër luftëra ti u zbardhe.

I the syrit njihe hasmin,
i the djalit lëre dasmën.

Gjysmo bukën, gjysmo gjumin,
digje për atdhenë kurmin.

T'u ul reja përmbi vetull
kush të shiti, kush të preku?

I the syrit njihe hasmin,
i the djalit lëre dasmën.

I the gishtit shkrehe çarkun,
i the zemrës derdhe gjakun.

Gjaku yt ka zënë rrënë
shqiptar, dyfek më këmbë!

K R I S T O F O R I D H I

Rri Kristoforidhi,
përkthen
ungjillin në shqip
tërë natën.

Nuk ndahet
dijetari pa fe
ditë e natë
nga kartërat.

Buit Elbasani
përreth,
rëndoijnë hurmat,
varin degët.

Ballërrudhur
mbi kartë ai hedh
fjalë nga toskët e gegët.

Kalon Elbasani
këtu,
me pëshpërimë
kristoforike

te piedestali,
nën kartërat mbi gju
dhe unë, poeti,
avitem.

Oi Kristoforidhi
te çezmat
pate bërë rrëmujë
pazaret
u shkelje plakave
vezët,
shënoje në kartë
dhe sharjet.

I mblodhe fjalët ti
tufë,
ua dhe shqiptarëve
në duar.
I lëshove si krisma
në rrugë
mbi gjithë shkelësit
e huaj.

Tek shkundje gjuhën
si pemë

me duar
 prej patrioti,
u derdhën mbi ty
 shovenët,
ta shtrinë me plumb
 Dhaskal Todrin.

Në Shoqatën Biblike
 tej detit,
të shkishëruan
 fetarët,
se gurët e sokakut
 i ktheje
në shkronja
 për gjuhën e të parëve.

U ende në Romë
 e në Londër
zhuritur
 nga fjala shqipe,
o plak i urtë,
 që në torbë
veç erën e detit kishe.

Dhe shkove kudo
 e u ktheve

këtu

te guri i vatanit,
mes gjuhës së zjarrtë,
mes reve,
mes pëshpërimave
té Elbasanit.

MINATORËT

Dëbora anembanë i zuri rrugët,
frym era me gjithë bulçinj,
e mali i rëndë si murg i mugët
përmbi qytezë u thinj.

Thua do ngrijnë gjithë harabelët,
thua dhe ti tani do të ngrish,
ah qafë e malit, o qafë e egër,
po ulërin si zgavër lukunish.

Po befas përmbi shtjellën e dëborës
një këngë ngrihet lart si triumf.
Po shkojnë varg i gjatë minatorët
mbështjellë me këngë e gozhupë.

As era që nuk di se ku të shkojë,
as loti i dëborës mbi qepallë
nuk mundet t'i kthejë minatorët,
t'i kthejë tek e diela t'i mbajë.



Me hapa tē gjatē prej atletësh,
po hyjnë një pas një te tuneli,
pas krahësh, nën qiellin e kreshpët
e diela, e zhveshur, jashtë ngeli.

Nga thellësitë e rënda tē nëntokës,
dyfish do tē nxjerri prapë krom
tē thjeshtët, tē madhërishmit e epokës,
që diell kanë në zemër gjithmonë

BLEGËRINË PRANË UZINËS DELET

Blegërinë pranë uzinës delet
si një gurgullimë e pafajshme,
ti ndër mend mua m'u derdhe,
Shqipëri e begatshme.

Me kullota edhe me stane,
me ullishta kaçurrelë mavi,
me uzina dhe hidrocentrale
dhe me dallgë të grurit të ri.

Gjithë ata që nuk të deshën
ty të shanë, o tokë, nga delet,
porse qumështin e tyre dhe leshin
si banditë deshën ta vjedhin.

Ju, të bardha dele, blegërini
si një pafajësi tek ura
e në fqinjësi të mirë ju rrini
me uzinat dhe hekurudhat?

FUSHA E VAJIT TË KUAJVE

O fushë e Vajkalit, fushë
e lotëve të hidhur të kuajve.
Në këmbë, pas pesëqind vjetësh,
qëndroj këtu pranë duajve.

Këtu ku korrin kombajnat
dhe s'dinë sa koka janë korrur
nga ti, o fushë, o mal,
armiqtë gjithë për t'i shporrur.

Unë që s'besoj në të pamundurën,
në lotin e kuajve besoj.
Sa trima këtu u këputën,
nga jelet u varën mbi tokë.

M'i shfaq majë kuajsh besnikë
gjithë trimat me jataganë,
që këtu i mbyllën sytë,
që këtu nga kuajt ranë.

Të ish trupi i tyre këta duaj,
unë rrija, i ruaja tani,
i ngrijë vetë në duar,
ua ndiqja korbat mbi sy.

Ata që bukë nuk kishin
kasolleve në brinjë të maleve,
po një kalë si shok e risnin
në virgjëri të livadheve.

Me të vetëtima çanin
Arbërisë betejë më betejë,
potkonjtë kërcisnin shkëmbinje
dhe shpata shkëlqente përherë.

O fushë e Vajkalit, fushë
ku ndalën vallë këtu?
Një mijë, thonë, ishin një mijë
dhe kuajt djersitur, bërë qull.

Dy ditë e ëy net këtu
sa shpata mbi osmanë vringëllinë,
sa çallma ranë, sa koka —
veç dielli dhe fusha e dinë.

Potkonjtë nuk ngrinin pluhur,
shtëllunga dufi këtu nxirrnin,
me kokat në qiell kuajt
prej goje zjarr shkrofëtinin.

S'i vërente dot malet sulltani
mes gjakut e pluhurit shtëllungë,
betejës larg i tmerruar
i binte allahut në gjunjë.

O fushë, këtu mbi mburoja
sa trima të përgjakëtë u shtrinë.
Rrodhi gjaku, ndoqi osmanët
curril luginë më luginë.

Kur çallmat e fundit humbën
pas malit të thatë në revan
u kthyen kuajt, hingëllinin
vështronin me sytë e xhamtë.

Me kokën e varur në dhe
mbi plagë, në fushë turfullonin
dhe e ngrinin pastaj në qiell
të zotët e tyre kërkonin.

Kérkonin kalorësit e tyre,
kérkonin bujxit e mirë
dhe dheun me thundra rrëmihnin
të ngriheshin nga ti të shtrirët.

Dhe vinte e ikte nata,
dhe vinte e ikte hingëllima
po zotët e tyre nuk ngriheshin
e loti u pikonte në ftyra.

O lot i hidhur i kuajve,
një fije bar pangrënë,
o vaj i bukur mbi trima
në fushë të Vajkalit rënë.

M O S H A R R O N I

Shokë,
ju duhet ta dini,
kriminelët
këtu
një mëngjes
varën
komunistin,
të riun,
të qeshurin,
Muhamet
Gjolleshën.

Ish mjegull,
acar,
ish shkurt,
në gjak
ecte dyzetekatra
me nazistë,
kuislingë,
pushtë,
me fytyra
posi masakra.

Ish natë akoma,
 ish ngricë,
e nxorën
 prej portës së hekurt
nga muret,
 matanë qelisë,
asgjë nuk shihej
 veç mjegull.

Dhe ngrinte gjaku
 mbi pllaka;
rreth muresh
 spiunë përrreth,
shokë,
 ju duhet ta dini
fashistët
 rrëmihin në terr.
E sollën zvarë
 të pafajshmin
nën pisha
 te sheshi i pazarit.
Njerëz,
 e dini ju mirë
pse trëmben armiqtë,
 kë varin?

T'ia thyenin trimit
 gjithë brinjët,
me brinjën e fundit
 si krisëm
në muret e burgut
 prapë shkruante:
Lavdi
 Parti,
 Komunizëm!

Ta shtrinin,
 prapë ngrivej nga dheu,
thërriste
 me zëra të tjerë.
Ta digjinin,
 e shihte vec nata,
si zjarr lirie
 përherë.

S'kish zbardhur dita,
 ish herët
mbi koka xhelatësh
 u var.
Ia mbathën tradhtarët,
 u fshehëن

dysheqeve
me barkun mullar.
Ndaloni,
ku shkoni, ku strukeni,
ne jemi shumë,
do t'ju gjemë.

S'vonon gropa juaj,
të shitur,
ne jemi
më këmbë pérherë.
Valavitej
trupi i mbytur
si kambana e madhe
në erë.

Qyteti u zgjua
nga hasrat,
po ecte kalldrëmeve
i zbathur.

Po ç'pa,
pse ndali tek sheshi?
I veti, Muhameti
i varur.

Mbuloi sytë
me pëllëmbë,
e sytë iu mbushën
urrejtje.

Ç'u bëtë,
tradhtarë të nëmur,
do t'ju gjejmë
kudo,
dhe në vdekje!

Dysheqeve,
trapezave,
skutave
do t'ua gjejmë
edhe mërmërimën.
Ikte fjala,
ikte ora
tutje
mbi çati,
mbi kopshtet me brymë.

Do t'ua gjejmë
dhe thikat,
dhe thonjtë,
dhe dielli
nga muret e lartë

kudo,
kudo ju väzhgon,
tradhtarë të atdheut
me damkë.

Kolovitej
trupi i njomë
si këmbana e madhe
mbi rrugë.

Dhe shokët,
mos harroni
shkonin
në luftë heroike,
në luftë.

A T D H E U

Dhe nuk i tha atij askush të vente
në uzinat e Metalurgjikut
dhe nënën plakë në kryeqytet ta linte,
fëmijët e mitur.

Po një atdhe që rron në gjithë gjokset,
në thellësi të pakapshme,
thërret kudo, në të gjitha frontet
drejt së ardhmes.

Dhe nuk i tha atij askush të mos flinte,
nën dritë prozhektorësh të montonte natën
dhe reja përmbi supe t'i ulej
me shiun e shtrëngatës.

Po një atdhe që rron në gjithë stinët
thërret me gjuhë të përveçme,
me gjuhën e nënës dhe fëmijës
drejt së nesërmes.

N JË T E L E F O N

Bie telefoni, bie telefoni
dëgjoni nëpër muzg, dëgjoni.

S'bie prej zyre dhe shtëpie,
prej njëqind metrash lartësie.

Bie mes qiellit e tokës
larg korridoreve dhe sobës.

Bie dhe bie në hapësirë
ky telefon me zë të mirë.

S'kërkon njeri kostum për plazh
dhe s'pëshpërit: aman, më qafsh!

Nuk porosit dy kile mollë,
dy copa dërrasa, antenë të hollë.

Beton, beton brigada don
se nata mbi oxhak afron.

E retë zbritën pos i puse
mbi supet e oxhakndërtuesve.

Beton, beton kërkon brigada
dijersitet skelave të larta.

Dhe ylli vetë në hapësirë
i njeh këta punëtorë të mirë.

Dhe këtë zë në telefon:
Beton, shokë, shpejt beton!

Bie telefoni, bie telefoni
dëgjojeni shokë, dëgjojeni.

SHQIPËRI E HEKURTA

Ku e mirrje vallë ti hekurin,
Shqipëri e hekurta,
rrëmet lirie që trondite shekullin,
ti e paprekura.

Ti që dorën nuk ia shtrive kujt
pothuaj edhe gurëve,
e blije çelikun për një copë plug,
me gjakun e duarve.

Dhe nëse edhe vajin tënd të paktë
e pate ti në pjatë,
e blije dhe hekurin e rrobave larg
të shtroje një jakë.

Po nesër do të shtrosh hekurudha
me çelikun tënd
e tokës do t'ia fshish të gjitha rrudhat
në çdo vend.

Nga urat e tua do t'u gëzohesh
traktorëve të tu,
ti që pazareve dhe tëlat e ballkoneve
i blije dikur.

Më lart pallatet e tua do ndërtosh
përballë gjithë Evropës,
më thellë nëntokën tënde do zbulosh
dhe pjellorinë e tokës.

Do rrish në sustë të shtratit tënd,
mes hekurit tënd në mure,
e më të mprehtë bajonetën do ta gdhendësh,
Shqipëri që s'u përkule.

DHE JU MUND TË MË PYESNI MUA

Dhe ju mund të më pyesni mua
dhe mund të pyesni cilindo këtu
çfarë është e re — furrnalta që montuam?
çfarë është e re — kombajna që korr grurë?

Dhe mund të më pyesni përsëri ju mua,
dhe mund të pyesni cilindo te ne
çfarë është e re — mos vallë hekurudhat,
mos trenat vetëtimë? Oxhaqet gjer në re?

E di: dhe trena elektrikë do kemi,
dhe avionë supersonikë do të prodhojmë vëtë,
po ne të lirë duam që të jemi
buzë detit tonë të qeshur gjer te retë.

Dhe duke u kthyer nga hidrocentrali
të mos na ketë ngulë gozhdë një trustoman,
t'i themi gruas: — Më ka marrë malli
në erë të maleve, xhan!

Të shkojmë me plot dëshirë në uzinë,
të ndiejmë fjalët e ngrohta të shtëpisë
dhe të mos dalim andej si një makinë,
që dita s'di për ku e rrukullis.

Ne duam të na dehë çdo fije bar në tokë
e zemra të na rrahë si krahë zogu;
të jemi ne të rinj duam, shokë,
gjer në rrënjet e flokut.

E për këtë mund të më pyesni prapë
e veten përsëri mund të pyesni,
se ç'himn teknikës borgjezi i ngre lart
si shpëtim të plagëve të shekullit.

Po Evropa ka vënë kokën në pëllëmbë
e qan e mbledh uzinave grushtet,
të mundej mbrenda natës i shkulte me rrënje
borgjezët edhe trustet.

Dhe ju mund të pyesni fare mirë
dhe mund të pyesni veten — Pse?
Sepse borgjezi është ujk për njerinë
uzinat — barku i tij përmbi dhe.

Po ne uzinat më lart do t'i ngremë
sa po të vijë një turist i huaj
t'i bien gjyslykët nënë këmbë,
të shkelë mbi mërzinë e tij si kuajt.

Po prapë mbi çdo gjë dora juaj mbetet,
që gatuan bukë dhe ledhaton fëmijë,
dora që frenon lumenjtë edhe detet
e nga dashuria i dridhen gishtërinjtë.

Dhe prandaj mund të krenohem unë,
dhe prandaj mund të krenohet cilido këtu
në atdheun tonë të ri gjithnjë në punë,
rini e përjetshme jeni ju!

NË ELBASAN NJË TURIST I HUAJ

Në Elbasan, një turist i huaj
pyeti një inxhinier:

— C'para për punë në muaj
merr?

— Unë marr një shumë fantastike, —
tha inxhinieri ynë.

— Siç duket, nuk bën të ma thuash, —
turisti i shkeli synë.

— Unë kam, zotëri, dy milionë, —
tha inxhinieri prapë.

U turbullua turisti i gjorë,
pyeti: — Në bankë?

— Unë kam dy milionë shokë, —
tha inxhinieri ynë.

Turisti mori i heshtur gotën,
gëlltiste e gëlltiste vetminë.

HUMORESKE

O ju montatorë në qiell,
në lartësinë njëqind e njëzet metra,
mos patë gjékund perëndinë
me të madhin e të mëdhenjve nga mjekra?

— Në qiell asgjë s'të zë syri,
po ne kemi parë në një dhomë
një burrë që lutej... dhe hyri
të fshihte diku një ikonë.

Aviatorë që ngriheni në qiell,
në lartësi të papara nga toka,
mos patë gjékund perëndinë
t'ia shpiem atij burrit te koka.

— Pamë, posa, mbi një re
tek shqyente një kofshë kau
dhe ia mbathi hajduti i hajdutëve,
si babë teqeje na ngjau.

T'i lëmë shakatë mënjanë
po perëndia diku do të jetë.
— Posi, perënditë janë
gjersa ekzistojnë budallenjtë.

KALOI NJË DITË MBI URË

Kaloi një ditë mbi urë
një ditë mbi urë kaloi,
fytyrën e punëtorëve nata
me gjumë tani e mbuloi.

Oxhaqet vështrojnë njëri-tjetrin
nga qielli i qetë dhe i lartë
dhe presin të zbardhë mëngjesi
presin në natën e gjatë.

Punëtorët të bukur po flenë
tani nën hënë elbasani
mos shohin gratë në ëndërr
në brigje në lule të vatanit.

E nata kalon përmbi urë
e qielli gëzohet nga yjet
e dihet, nesër në punë
oxhaqet më lart do të ngrihen.

FLAMURI YNË

Zotërinj, nuk shesim
ne flamurë,

Një flamur kemi
s'e shesim kurre.

S'e blen dollari
dhe as rubla.

Flamur prej gjaku
jo prej puplash.

Flamur, zotërinj
që asnë bangë

s'e regjistron
për katafalkë.

Flamur lirie,
flamur me emër.

Flamur partie
mbi çdo zemër.

Flamur, zotërinj,
dhe jo pëlhirë

nuk shitet e s'përkulet
kurrë.

Përkulet vetëm
mbi të rënë

që thellë tokës sonë
flenë.

POEMA E NËNËS DHE BIRIT

Nënë Sillon ku e shpien?
Natë.

Qyteti portëmbyllur,
mbi çati një shportë me yje.
Orë e vonë kur ftohet guri,
orë e thatë njëmbëdhjetë.
Ku e shpien Sillo Durin?
Nëpër gropë rruga shkretë.

Prapa saj i zi si nata
një kordon me milicë,
bajonetat
teh të thata
ngricë çeliku mbi rrugicë.

Përmbi natë duke shkarë
ajo shkon e mban në duar
një shami me lotë lagur,
loti nënës ka pikuar.

Krismë e gozhdëve kërcet
i gërvishi edhe yjet,
ku e shpien nënë Sillon,
Sillo Durin ku e shpien?

O qytet,
 ti i rrogozit,
o qytet,
 me arna gjunjëve,
o qytet,
 me rrudha nëne,
o qytet ti,
 me burgje.

Ku e shpien nënën tënde
nëpër natë grop' më gropë?
Po e shtyjnë me kondak,
portë hapu, hapu portë!
Hapu portë e prefekturës
port' e mizorisë,
 hapu,
gjithë qyteti nëpër natë
nënë Sillon mban për krahu.

Djali i saj Mihal Duri
është shtrirë si në ëndërr;
me fytyra prej guri
rrinë xhandarët mbi të, vëngër.

Rri prefekti,
kuestori
të mbërthyer teh më këmbë.
Kanë frikë, kanë frikë
se mos ngrihet prapë i rëni.
Ngrihet, u rrëmbejn koburen,
u derdh plumb në gojë e ikën,
rrëzon puplat, rrëzon muret,
rrëzon sofra, rrëzon klithma.

Ikën, ikën, prapë në rrugë
e fsheh nata dhe çdo strehë
mbledh të shtypur, të papunë,
mbi fashistë grushte mbledh.

Kanë frikë, kanë frikë
gjer në fund në varr të tyre.
Po Mihali s'ngrihet dot
gjak prej flokësh, gjak prej syve.

Hëna ndrit, i zbulon plagët
nën qiell alumini,
ku e shpien nënën plakë,
vrasës, vrasës ku e shpini?
Hapu, portë e prefekturës,
portë e mizorisë, hapu!
Gjithë qyteti i përzemërt
nënë Sillon mban për krahu.

O i bukuri i nënës,
dritë e kuqe mes oborrit.
O i shtrirë në lule gjaku,
ç'do prefekti, kuestori?

Duan shokët, ku ke shokët,
cilët janë shokët e tu?
Nëna ty të lëmon flokët,
thotë nëna: Kurre! Kurre!
E pështyjnë,
e kërcënojnë,
i tregojnë nënës burgun.
Buzët prapë po ëmbëlsojnë,
thotë nëna: Kurre! Kurre!

Trim i nënës, komunist,
hallall ty të rriturit,
se u vrave mbi fashistë,
se u vrave mbi të shiturit.

O i bukuri i nënës,
o i bukuri i qytetit,
të kanë frikë, u ngjethet mishtë,
rrotull vijnë si të dehur.



O qyteti i nënave,
e kanë frikë ballin tënd,
tmerr u shtie edhe nëna,
pikon tmerr, po i çmend.
O qytet me dorë në armë,
të kenë frikë, o i patrembur.
Ngre dhe baltën përmbi ta,
ngre mbi ta edhe të rënët.

Pse po ikin, ku po venë
nëpër natë porsi hije.
Kanë frikë, kanë frikë
gjer në fund, në varr të tyre.

FLOKËTHINJURI ME ÇIBUK

Gjyshi Lon e ka shtëpinë te pranvera
pranë plugut të artë në muzg.
Nëpër këngë, nëpër flakë dhe luftë
vjen ai nga çdo brinjë, çdo hon.

Se ka ecur me dogranë krahëve
për vatan, nën qiej shkrumb
duke u hedhur duhan plagëve,
duke u derdhur shovenëve plumb.

Gjyshi Lon, që s'di se nga ç'luftë
përmbi vetull i mbeti kjo shenjë,
lisave të malit vari armët,
gurëve shtroi sharkun nën hënë.

Erdhi mosha e gjunjëve të prera,
nëpër dallgë kujtimesh ngec.
Nëpër kopshte po ecën pranvera,
mal më mal Shqipëria po ec.

A mos erdhi kjo pranverë në oborr
për vizitë posи bijëz e butë?
Vetë e mbolli këtë grurë lumturor
flokëthinjuri me çibuk.

Prapë fidanët në kopshet e bruztë
ai shkon, me merak i vadit,
flokëthinjuri posи këshillë e urtë,
që s'i mbajnë më këmbët e sytë.

TRENAT NË MAL

Vërvshëllejnë trenat në brigje
aq të lehtë si ajri i maleve.
Dola unë te binarët e tyre,
trena, kurrë ju të mos ndaleni!

Trenat ikin si pa shkas nëpër erë,
kavaleri e hekurt mes malit.
Doli vjeshta, u hedh gjethë ari
dekorata mbi mineralin.

Malet rrinë përpjetë dhe habiten,
si po munden të ngjiten, si?
Malet s'panë aq lart nëpër shekuj
vetëm kuaj të ngarkuar, veç dhi.

NJË MESNATË NË FUSHË

Një mesnatë më doli gjumi
përmbi sy një plep i bardhë,
përmbi plep natë e drojtur
ikte zbathur dalngadalë.

Për te dita nata shkonte
me hap të butë duke ecur,
hënë e prerë në degë plepi
si kunadhe kishte ngecur.

Yjtë në qiell po rrallonin,
kur dëgjoj befas një zhurmë.

Që nga vinte, për ku shkonte
a mos vinte vallë tek unë?

Valë-valë zhurma ngrihej,
Më pat zgjuar ajo ndoshta
që nga zemër e dheut dilte
përmbi fushë,

përmbi gropë.

Rrapëllimë

nëpër natë
trembte zogjtë
edhe hijet,
e të hollin plep mbështillte,

posi foshnje

plepi dridhej.

Mos u tremb, mik, i thashë
mos u tremb, plep i bardhë.

Vijnë traktorët nëpër natë,
nëpër fusha duke ngarë
dhe siç duket po shpejtojnë
t'i dalin agimit para,
për të mbjellat raportojnë
tërë natën e garave.

Hajde, plep, ngre laureshën,
ti me këngë përshëndeti.

Mos u tremb nga miqtë e fushës,
janë shokët e poetit.

N E

Ne s'jemi emra në gramatikë
as bishta shtetesh si prapashtesa,
nga ne armiqtë i zë frika
edhe të shtrirë në varreza.

Ne jemi njerëz luftëtarë,
ne jemi njerëz që gëzojmë,
armiqtë dridhen me llahtarë
edhe nga këngët që këndojmë,

Ne s'jemi gurë të thatë varri,
ne jemi gjak që lëviz kohën,
ne kemi zemër prej ushtari
më këmbë qëndrojmë ballë Evropës.

Kur vendin tonë ne çliruam,
kur vendin ngritëm që nga varri
te kokë e tij ne u betuam
s'na prek askush një fije bari.

S'u mbyllëm ne mehmurë në zyra
as si kostume në vitrina,
ne shkojmë ku thërret detyra
për Shqipërinë, për Shqipërinë.

Këtu ku lindëm ne dhe biem,
këtu ku biem, prapë jetojmë;
armiqtë dridhen posa hijet
edhe nga këngët që këndojmë.

NJË NJERI I MREKULLUESHËM

*Edhe nëqoftëse vritet Mrika,
burra e gra ka plot Mirdita.*

Ajo zbriti, ndehu duart mbi tesha.
Po në natën e dyzetetës, në mal
pa mbledhur teshat e bardha mbetën.

Mbetën udhët e Mirditës në pritje,
mbetën shokët në Rrëshen në telefon,
duart e saj të ndera në ajër.

Shaj partinë! — ulërinë banditët;
bajraktarët, priftërinjtë, kulakët
në ulërimë ishin mbledhur: — Shaj!

Sha-aj! Shtrembëronin nofullat e egra
po ajo partinë nuk e shau,
nuk e shante lirinë e vet, e bukura.

Ish maj,
edhe lulet atë natë u përgjakën.

Malet nisën që të vërtiten mbi ta,
do i'i gjenin dhe në varr të futeshin.
Gra e burra kish plot Mirdita.

RRUGA E BARIKADAVE

Këtu ku ushkuri fshinte pluhurin dikur
e lypsat zgjatnin duart në kotësinë e erës,
kalonte poshtërsia e tij, mbreti,
si një çiban në sedilje të veturës.

Kjo rrugë ish pothuaj e vetmja e qytetit,
mbretërore quhej.

Ata që e ndërtuan s'kishin nallane në këmbë,
shkelnin zbathur

në trotuarin e ftohtë,
me rrudha në ballë vështronin veturën
Trishtonte rruga,

pështynte gëlbazë mbi pllaka,
pështynte hidhërim dhe gjak.

Duke dihatur, duke rënkuar hamejtë
kapërcenin portat drejt Pazarit të Vjetër.

Më shumë miza kishin dyqanet se klientë,
tregtarët te banaku kruanin zverkun,
e Tirana e uritur kërciste dhëmbët,
e rruga me zemërim shtrëngonte nofullat.

Te porta e kuesturës qëndronin më këmbë
milicët e Papalilos të zinj si korbat.

E bejlerët lëkundeshin me takë të larta,

me ombrella,

me parfum

mbi dhembjen e rrugës,

imitonin duke u tundur si rospi

italjankat,

imitonin pushtuesit.

Dhe rruga mblidhte grushtet nën strehët

dhe ngjiste thirrje partie në mure.

Këtu ku kuestura si sy i egër

vëzhgonte me tmerr dhe zgjohej.

O rrugë e shkelur, e shtypur, me gropat,

o rrugë me asfalt ku ecën liria,

ç'e ke këtë shtëpi,

këtë oborr,

këto topa?

Pa thuaj si gjëmoi këtu historia.

Këtu ku njerëzit para reklamave nxitojnë

të gëzuar, në mrekullinë e punës,

dritaret e Muzeumit të Luftës vështrojnë

nëga thellësia e kohës mbi rrugë.

Vizitorë që hyni te kjo ndërtesë,

në vitin e paharuar dyzet e katër

nëntëmbëdhjetë ditë e nëntëmbëdhjetë net

këtu, kjo rrugë u mbush barrikada.

U derdh Tirana si lumë për çlirim,

u ngrit qyteti këtu posa mur

me krevatet e fjetjes,
me dyshekë,
me qylymë,

me fuçi, me thasë, me gurë.

Që tanket e rëndë, autoblindat naziste
të mos kalonin e shtypnin lirinë,
dhe pemët e oborrit fukarai i priste,
dhe jastëkun e nuses e vinte stivë.
Dhe trupin këtu ta shtrinte ish gati
Tirana e kuqe me partizanin e vet.
Barrikadë, sulm, prapë barrikadë
nëntëmbëdhjetë ditë, nëntëmbëdhjetë net.

O mure goditur nga mijëra predha,
o rrugë shkallmuar nga tanke rrëmet,
o shtëpi pa dritare mbetur të verbëra,
tregoni dhe ju, o drurë, o degë.

Vinte nata dhe ikte,
vinin tanket, ktheheshin
me zhurmë, me tym, me panik.
Gjenerali nazist duke shkulur leshërat
i kapte kuisling-ballistët për fyt.

Të mbërthyer me kapota të murme
iknin fashistët nga kjo rrugë,
ky qytet,
po britmë e çlirim i gjente të murmit,
u dilnin partizanët në çdo bërryl-bajonetë.

E rruga shpërthente si krahë i tendosur
mes predhash pa numër, mes tymit, mes flakësh
nga dritaret e djegura partizani i panjohur
hidhej këtu mbi koka barbarësh.

Dhe plumbi, dhe thirrja, dhe kënga i korrte,
i shtrinte armiqtë në çdo strehë, në çdo kthinë.
Rënkonin shkallët e drunjta

të hotel «Metropolit»,
nën këmbë partizanësh
këcisnin si brinjë.

Kërciste,

rënkonte

gjithë mbretëria e kohës.

E rrëzohej si suva nga muret këtu,
rrëzoheshin barbarët e qiellit e të tokës
nën drurët e vjeshtës në baltë e në pluhur.

O porta të hershme, o mure të vjetër,
ku gjak heroizmi rroddhi dikur,
kalojnë njerëzit si lumë i potershëm
e mijëra kujtime ngrihen flamur...

NJË PARTIZAN NË MATHAUZEN

Avioni fluturoi dhe u ngrit
nga aerodromi i Rinasit dalngadalë
dhe iku tutje nën qiejt ballkanikë
një partizan me vete duke marrë.

Unë mbeta në këmbë me skulptorin
duke vështruar horizontin tutje.

Avioni si zog tej kaltërsisë
dalngadalë, dalngadalë po zhdukej.
Po ikën partizani ynë në bronc
dhe ndoshta atje lart ndihet ngushtë
mes pasagjerëve ajrorë që rrinë
të qetë mbi kolltukë.

Nuk shkon që të zvaritet në biseda,
në tregti politikanësh,
jo s'do të zbresë në pazare konferencash
i dërguari prej Tiranës.

Përmbi qytete të zhurmshëm të Evropës
u nis ai për udhë
jo s'e i pëlqen çmenduria e modës,
reklamat,

bulevardet plot rrëmujë.

Ai s'është vizitor klubesh nate
ku shpirti qan mbi një gotë birrë

ndërsa të rinj me çizme dhe shkopinj
i thyejnë xhamat qytetit në fytyrë.

S'ka marrë rrugën
jo,
të bëjë kryq
përpara ikonave të Krishtit
në kisha
ku kércejnë rokenroll
tregtari,
krishti vetë
dhe fashisti.
As arratiset në vetmi prej bote,
nuk shkon të falet ai në Mekë,
Jo, kurrë!

Prej kësaj toke
buron gëzim lirie dhe shëndet.

Evropë, ngri kokën dhe vështro,
një partizan u ngrit në qiell,
nën këmbët e tij një nazist rënkon
nga qyta partizane i mbërthyer.
Nuk është,

jo,
një ëngjëll i hyjnisë
me krahë të fluturojë
si në bibël.

Me avion

 të Republikës Popullore të Shqipërisë
një njeri në bronc
 drejt Mathauzenit nisëm.

Nga zemra e maleve ai doli
u ngrit si tridhjetë vjet më parë,
e gdhendi shoku i tij, skulptori,
përjetësisht
 të gjallë.

O ti, që dëgjon fjalime presidentësh
në mjegull, në tym kabaresh,
o ti, që gëlltit gënjeshtra
 prej regjentësh,

shiko

 mespërmes resh —
si një dëshmi e zemrës sonë,
që rreh

 me dashuri të vërtetë.
një luftëtar prej tokës sonë
në Mathauen

 zbret.

Atje ku eshtrat dogjën furrat,
atje ku mishin bënë sapun,
një partizan prej Shqipërie vjen,
jo një pëllumb!
Nën këmbë të tij helmeta e Rajhut
dhe kryqi i Hitlerit copëtuar.

Një shqiptar
godet me gjithë krahun,
një pushkë

vazhdim i duarve.

Ai u ngrit pesë vjetë më këmbë
rrethuar nga tanke dhe avionë,
malet e tij i shkuli mbi armiq.

Shporruni! —

u tha, —

prej nesh përgjithmonë!

Nuk kish ai akademi e grada,
nuk kishte pirë uiski me gjeneralë
në çantë kish vetëm pak bukë të thatë,
në trup kish plagë.

Pa ngrije kokën, Evropë,

vështro drejt

një luftëtar të Shqipërisë së lirë
atje në park,

në Mathauzen zbrët
me pushkë mbi egërsirë.

Kush tha se iku koha e armëve,
kush tha ato të mbyllen në muze?

Nën zhurmën e çmendur të kitareve
sovjeto-amerikanët deri në Mesdhe
po fryjnë barkun eksploziv të bazave
që ta pëlcasin diku përmes Evropës.

S'i kalojnë kufijtë për paradë
ushtritë e ushqyera të Moskës.

Ai që tha,

Mathauzenin e harroi
i ktheu krahët popullit të tij
dhe shkoi të ulet në bankete
me agresorë.

Ai është tradhtar i lirisë,
është tradhtar i foshnjave në sisë,
i qiellit të vet mbi fytyrë.
Ne armën e mbajmë prapë në duar,
në mes Evropë sot atë e ngulim.
Nuk rrjimë të qajmë me lotë fatalë,
e shkrehim,

po të duhet.

NJË MBRET QË MBRETËRONTE DIKUR

Na ish se ç'na ish,

një mbret ish dikur,

te seli

e Akademisë së Lartë të Shkencave,
jetonte rrethuar me dy palë mure
më të lartë se manastiret e murgeshave.

E mbreti mbante emrin fluturues, Zog,
po nga zogjtë nuk kishte as pendët.
S'lëvizte nga dhoma,

nuk dilte në portë,
me gjak i kishte duart e këmbët.

Fluturim më i zakonshëm, më i dendur i Zogut
shkonte prej fronit gjer te tualeti.

Kish të drejtë monarku, fare s'kish kohë,
rrëmihte dhe zbrazte thesarin e shtetit.

Ish bukurosh, me faqe të lëmuara paq.

Në pyetshi, kush ia dha yndyrën e faqeve,
mos pandehni mbretëresha, Geraldina, në shtrat,
po ari i Shqipërisë depozituar bankave.

I pëlqenin traktatet, me Italinë veçanërisht,
e po, mbreti me mbretër i lidh fjalët.
Kreditë e huaja i bënte vila
dhe shpërblente miqtë
që koburen shkrehnin mbi republikanët.

Nga njëri xhep napolona mercenarëve u hidhte
dhe xhandarëve me dajak në dorë e kobure,
nga tjetri — shaminë e Geraldinës nxirrte
fshinte lotët, «i shkreti», te muret.

Në festa ky mbret shpesh vinte qeleshe
dhe vizitonte ndonjë han me oficerë e me kuaj.
S'shëtiste Evropës, —
niste ministrat, kodoshët e vjetër,
pastaj, brenda ishin të gjithë të huajt.
Kush krom,
 kush pambuk,
 kush naftë,
 kush ullinj.

Hynin,
 dilnin mes popullit pa bukë.
Naltmadhnia macen përkëdhelte me gishterinj
dhe i jepte turtë.

Po për çudi edhe të kuajve të princeshave
ky mbret s'priste kë,
thua ish mizantrop.

Vetëm një njeri që rronte si dhjami mes veshkave
hynte-dilte,

bile derën duke shtyrë me shkop.

Ishte Lalë Krosi që shtynte jo derë po ministra,
arroganti më i besuar, me buzë si gjyveç.

Vetë ministri i Brendshëm i jepte në dorë kyçat:
— Naltmadhnisë,

or babë,

për mue një fjalë veç!

Deputetët nuk luteshin për Krisht,

për Muhamet,

Luteshin e përgjëroheshin për mbretin Zog.

Naltmadhnia ish at,

ish bir,

ish shpirti i shenjtë,

Ish para, ejvallah, ish ciflig,

ish poet!

Po t'i shkrepte naltmadhnisë

të priste mustaqet

i prisnin me radhë oborrtarët,

deputetët.

Reformë e madhe për mbretërinë kjo shpalëj
e sanksionuar me thikat e mbretit.

Deputetët nuk dinin të hidhnin as firmën,
iknin nga parlamenti, luanin kumar në «Kursal».
Fëmijë të leckosur, të uritur në verë e dimër
zgjatnin dorën, shtypnin hundën mbi xama.

Pëllisnin kasnecët rrugëve, thërrisin gazetat
se mbreti do të ndërtonte një urë botore.
Po poshtë urës, dihet, do të flinin të vobektiët
duke dëgjuar përralla mbretërore.
Ama në pallatin mbretëror, po të zhuzhiste
një mizë mbrenda mureve me lëmyshk,
njëqind oborrtarë kishin punë tërë ditën,
e dikush gradohej, natyrisht.
Që të mos i prishej qetësia mbretit
tek bënte plane të errëta me popullin,
treqind e ca hapa larg portës së hekurt
ndalohej rreptësishët të qeshurit, të kollurit:
Medet po të krakariste natën një sorrë,
mbi shtrat të mbretit Zog tek dritarja.
Në goftë se fallxhiu i thirrur s'ish i shkathët e horr
e priste varja.

Kur dilte naltmadhnia në oborr, në pranverë,
rojet kishin urdhër të ulnin tytat.
Atëherë në qytet qarkullonte derë më derë.
— Ka dalë e po shëtit frika.

Ku ndodhej naltmadhënia, e dinin të rrallë:
Në Pallat? Në vilë në Durrës?

S'merrej vesh.

Fillonin përshpërisnin

kur e shihnin te shkallët,

— Asht lodhë,

po shkon të çlodhet, për besë!

Dhe urdhër i prerë

gjithë qytetit i vinte, —

të mbyllte dritaret, portat, qepenët,

askush, askush në rrugë të mos dilte.

Mos mjaullinin as macet, as qentë.

E mbreti i hypte i trembur veturës
dhe shkonte, pas krimeve,

të pushonte në vilë

Dhe ndodhë që oficerëve u binin gradat rrugës,
nuk e ruanin, të shkretin, mirë...

Na ish ose ç'na ish, një mbret ish dikur.

Këtu ku është sot Akademia e Shkencave.

Jetonte rrethuar me dy palë mure,
të tjerat — ua thonë dispencat.

MIS RITÇEJ DHE QENTË

Misis Ritçej tetëdhjetëvjeçe
s'do dalë më në bulevard,
rrotat e veturës s'do ta shpien
në barin e vjetër të kujtimeve.

Misis Ritçej shtrirë në shtrat
duart zgjatur përmbi çarçafë,
tetëdhjetë qen lehin në oborr:
misis Ritçej, mos vdis!

Tetëdhjetë qen zgjasin turinjtë
dhe hungrijnë përmbi dritare.
Ku janë vellezërit Ritçej,
të afërmit e miqtë ku janë?

Ku janë kollarot e zotërinjve,
pasqyrat të vetmuara presin.
Kapelet e tyre në korridore të vilës
nuk mbahen mend prej vjetësh.

Misis Ritçej tetëdhjetëvjeçe
tetë fjalë tani dot s'i mbledh.
Më s'do të shajë e s'do të grindet
e zogjtë s'do t'i trembë nga pemët.

Bastuni i zi në qoshk të dhomës
s'do rrrotullohet si kërcënim,
një kone e bardhë në duart e saj
fërkohet dhe angullin.

Misis Ritçej, mos vdis, o mis,
o më e bucura zonjë Amerike,
po trëndafili indiferent bie
nga flokët e saj mbi karrige.

Shkon lajmi i vdekjes larg përnjëherë,
vëllezërit Ritçej mbushin gotat,
pinë për vdekjen e saj vëllezërit
duke bërë llogari të ftohta.

Njëri shëtit zot nëpër vilë,
tjetri tërheq dollarët në bankë
hera e parë ata po dehen,
hera e parë ata rrinë bashkë.

Po tetëdhjetë qen mbajnë në dhëmbë
dollarët e misis Ritçej,
misis Ritçej i ka lënë testament
tetë milion dollarë për qen.

Mblidhen vëllezërit, ulërijnë në gjyq,
blejnë, kundërblejnë gjyqtarët.
Po tetëdhjetë qen angullijnë tek dyert,
angullima u ngjitet në mish.

Ç'të bëjnë? Avokatët mbledhin supet.
Vëllezërit njëri-tjetrin po hanë.
Dhe vetëm qentë atje janë zbutur,
po njerëzit egërsuar janë.

MORA VESH SE NË NJË SHTET TË HUAJ

Mora vesh se në një shtet të huaj
në kryeqytet
në zemër të kryeqytetit
po ndërtojnë një pallat,
Pallat i Drejtorisë e ka emrin.

Mora vesh se ky pallat i lartë do të jetë
gjer tek perëndia i Apollonit
dhe i xhamtë, i bardhë
si jaka e vetë prokurorit.

Dhe prokurori, juristët, autoritetet
do të kenë punë shumë
po më shumë ministrat
ministri i drejtësisë i pari
e deputetët do të rrotullojnë
tespijet te xhamet.

Ministri i drejtorisë do të dalë në tribunë,
(në mos vetë kryeministri)
do të kruaj grykën
(dhe kurrizin mbrapa)
— Popull! — do të thotë —
ja, nga drejtësia
të ndajnë dy hapa!

Dhe do të përmendë në fjalim burgun e zi
dhe pallatin që atje u ngrit
dhe perënditë e virgjëra
dhe rendin e virgjër
demokratik.

Po netëve do të mblidhen të papunët atje,
të uriturit (dhe të miturit)
do të flenë tek shkallët.

— O pallat i bardhë
jeta jonë është e zezë,
na dhëmbin shpirtërat,
na therin kokallët!

Do të dëgjojnë policët e fabrikantët atëhere,
e do të hapet libri i drejtësisë
në Pallat.

Do të çelen proceset
mbi të mjerët,
mbi kryengritësit
varg.

O pallat, kush të shpiku do rënkojnë atëhere
të mjerët,
ti dhe statujat po i dënon,
dhe këngët
dhe erërat.

Dhe pallati i lartë do të shtrembërohet më shumë
mbi qytet
i zi si nata,
burg i vërtetë.

P A S Q Y R A E L E N D E S

| | |
|---|----|
| Moj famëmadhe | 3 |
| Të lirë kush e do vatanin | 5 |
| Poemë për Birçe Sinematin | 7 |
| Shqiptar | 11 |
| Kristoforidhi | 13 |
| Minatorët | 17 |
| Blegrinë 'pranë uzinës delet | 19 |
| Fusha e vajit të kuajve | 20 |
| Mos harroni | 24 |
| Atdheu | 30 |
| Një telefon | 31 |
| Shqipëri e hekurta | 33 |
| Dhe ju mund të më pyesni mua | 35 |
| Në Elbasan një turist i huaj | 38 |
| Humoreske | 39 |
| Kaloi një ditë mbi urë | 41 |
| Flamuri ynë | 42 |
| Poema e nënës dhe e birit | 44 |
| Flökëthinxhuri me çibuk | 49 |
| Trenat në mal | 51 |
| Një mesnatë në fushë | 52 |
| Ne | 54 |
| Një njeri i mrekullueshëm | 56 |
| Rruga e barrikadave | 57 |
| Një partizan në Mathauzen | 61 |
| Një mbret që mbretëronte dikur | 66 |
| Mis Ritçej dhe qentë | 71 |
| Mora vesh se në një shtet të huaj | 74 |

Ndreqje gabimesh

| Faqe | Rreshti | si është | si duhet |
|------|---------|-------------|--------------|
| 36 | 14 | e qan | e fshan |
| 48 | 14 | të kenë | të kanë |
| 60 | 10 | këcisnin | kërcisnin |
| 61 | 19 | s'e | se |
| 68 | 14 | me popullin | mbi popullin |